



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:270209  
Datë: 24.01.2024  
Numri i dokumentit: 05230711

**AA.nr.19/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit F... Z... të cilën e përfaqëson me autorizim av.V... Z..., kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës në Prishtinë dhe kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2545/2018, të datës 02.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.12.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuara ankesa e të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2545/2018, i datës 02.11.2022, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2545/2018, të datës 02.11.2022, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, është aprovuar pjesërisht padia dhe kërkesëpadia e paditësit, F... Z..., ashtu që anulohet si i kundërligjshme vendimi i të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, A.nr.486/2018, i datës 21.09.2018. Në pikën II të dispozitivit refuzohet kërkesëpadia e paditësit në pjesën që ka të bëjë me anulimin e vendimit të të paditurës MPB- Komisionit të Ankesave në Policinë e Kosovës, me nr. të lëndës 44-KA-A/2018, i datës 14.06.2018, ashtu që i njëjti vëretohet si i drejtë dhe i ligjshëm. Në pikën III të dispozitivit refuzohet si e pabazuar pika e tretë e kërkesëpadiës së paditësit me të cilin propozohet që e paditura ti lëshoj paditësit vendim tjetër me koeficient 7 të pagës, dhe t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar ashtu që ti paguaj në mënyrë retroaktive diferencën në pagë nga data e paraqitjes së kërkesës së datës 07.03.2018 e deri në përfundim të procedurës administrative, me kamatë vjetore 8%. Në piken

IV të dispozitivit është vendosur që ky aktgjykim zëvendëson aktin e anuluar. Nen piken V të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur e autorizuar e të paditurës Zyle Millaku Gojnovci - zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, për shkak të: shkeljeve të dispozitave ligjore të procedurës administrative dhe kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit - Departamenti për Çështje Administrative ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta anuloj aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkalles së parë si jo ligjor dhe të mbetet në fuqi vendimi me numër A.nr.486/2018, i datës 21.09.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si i bazuar në ligj.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, avokat V... Z... nga Prishtina, ka parashtruar përgjigje në ankesën e të autorizuarit të paditurës, duke propozuar që lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesa, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e pa bazuara**

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë me vendimin A.nr.486/2018, të dt.21.09.2018, e ka hedhur poshtë si të paluejuar ankesën me numër A.nr.486/2018 të datës 24.07.2018 të parashtruar nga ankuesi F... Z.....

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 24.10.2018, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkalles së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, të paraqitur kundër vendimit të paditurës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon pjesërisht si të bazuar, duke vendosur si në dispozitivin e tij. Me arsyetim se gjykata, për të vlerësuar ligjshmërinë e tij i'u referua Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, nga edhe del se vendimi i kontestuar me A. nr.486/2018 përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji. Kështu vendimi i kundërshtuar del se është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në dispozitivin e tij është hedhur si e palejuar ankesa e paditësit e datës 24.07.2018, ndërsa në arsyetimin e tij e paditura thekson se kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankesa e datës 30.08.2018 e parashtruar në Policinë e Kosovës është e paraqitur jashtë afatit ligjor, sepse sipas kësaj të paditure momenti kur ankuesit kishte filluar të rrjedh afati për ankimim është momenti kur ankuesi ka pranuar vendimin nr.ref.07/01-01A/1704 të datës 27.04.2012. Pra me vendimin e kontestuar e paditura KPMSHC kishte hedhur ankesën si të palejuar pa treguar arsyet e palejshmërisë dhe pa bërë të ditur bazën ligjore të një vendimmarrje të tillë. Për më tepër gjykata ka vlerësuar se ankesa e parashtruar te kjo e paditur e ka përmbajtjen dhe formën e saj si edhe është përcaktuar me nenin 126 paragrafi 1 të LPPA, ku është përcaktuar: “1. Ankesa duhet të përcaktojë aktin apo heshtjen administrative që ankimohet, shkaqet dhe arsyen pse ankimohet dhe organin publik kompetent për aktin”. Pra përmes të njëjtës paditësi bënë të qartë se kjo

ankesë paraqitet kundër aktit administrativ të nxjerr nga Komisioni i Ankesave i MPB me nr.ref.44-KA-A/2018 dhe përmes saj ankuesi/paditësi kishte paraqitur arsye dhe shkaqe pse e kontestonte të njëjtin. Më pas gjykata gjeti se paditësi vendimin e kontestuar nr.ref.44-KA-A/2018 e kishte pranuar me datë 25.06.2018 dhe kundër të njëjtit, konform këshillës juridike, e parashtron ankesën tek e paditura KPMSHC si organ kompetent me datë 24.07.2017, do të thotë brenda afatit prej 30 ditësh. Pra nga kjo e vërtetuar del se paditësi ankesën e kishte parashtruar në përputhje edhe me nenin 128 paragrafi 1 dhe 129 paragrafi 1 të LPPA. Pra nge e gjithë kjo del se nuk ekzistonte asnjë bazë ligjore që ankesa e paditësit të hidhej e pa lejuar apo e jashtë afatshme. Për më tepër pretendimi i të paditurës KPMSHC se, kolegji ka konstatuar se ankesa e paditësit e dt.30.05.2018 është jashtë afatit ligjor, pasi që sipas saj afati i ankesës ka rrjedhur nga Vendimi me nr.ref.07/1-01A/1704 i dt.27.04.2012, është pretendim i paqëndrueshëm pasi që ankesa e paditësit nuk kishte për objekt vendimin me nr.ref.07/1-01A/1704. i dt.27.04.2012 por ishte parashtruar për shkak të heshtjes administrative të të paditurës MPB në raport me kërkesën e datës 05.04.2018 të parashtruar nga Drejtori i DTIK, e me të cilën ishte kërkuar emërimi i tij në pozitën Specialist i tavolinës ndihmëse.

Prandaj sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë e paditura me marrjen e një vendimin tillë kishte konstatuar gabimisht gjendjen faktike dhe më pas ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, kur kishte konstatuar se ankuesi ka parashtruar ankesën në kundërshtim me nenin 130 paragrafi 1 shkronja a) të Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L-28 dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave. Rrjedhimisht me rastin e ankesës e paditura KPMSHC ka qenë e obliguar të lëshohet në shqyrtimin e saj pasi që nuk ka pasur bazë ligjore për ta hedhur të njëjtën si të palejuar. Kështu sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë ky organi i paditur, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, në këtë rast kishte nxjerr një vendim të kundërligjshëm, prandaj mbi këtë bazë gjykata e anuloi të njëjtit duke vendosur si në paragrafin 1 të këtij aktgjykimi. Dhe mbi këto arsye gjeti se pretendimet e paditësit për anulimin e vendimit të kësaj të paditure janë të bazuara.

Gjykata së shkallës së parë me qëllim të vendosjes meritore ka aplikuar dispozitën ligjore nga neni 46 par.4 të Ligjit Nr. 03/L-202 Për Konfliktet Administrative, në të cilën është përcaktuar se: “4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar.” dhe mbi bazën e kësaj dispozite ligjore vetë është lëshuar në shqyrtimin e ankesës së paditësit të parashtruar me datë 24.07.2018, kundër vendimit të të paditurës MPB me nr.44-KA-A/2018, të datës 14.06.2018. Dhe me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë, gjykata së shkallës së parë gjeti se vendimi i kontestuar i të paditurës MPB është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe këtë për arsye se kjo e paditur me të drejtë kishte vlerësuar se ndryshimet e vendeve të punës si dhe ngritja në pozitë e shërbyesve civil, dhe në këtë rast edhe e paditësit si shërbyes civil i punësuar te kjo e paditur, duhet të bëhet në përputhje me Rregulloren për Procedurat e Rekrutimit të Shërbyesve Civil si dhe Rregulloren për Avancimin e Shërbyesve Civil nr.21/2012. Te kjo gjendja faktike, gjykata së shkallës së parë ka ardhur pasi shqyrtoi Kërkesën e parashtruar nga Kapiten F... R... me datë 05.04.2018 dhe pasi shqyrtoi ankesën e paditësit të datës 30.05.2018, përmes të cilave bëhet e qartë se nga punëdhënësi në këtë rast e paditura MPB është kërkuar emërimi i paditësit nga pozita teknik në specialist të tavolinës ndihmëse. Se ky emërim nuk paraqet transferim por avancim/ngritje/gradimi në një pozitë me koeficient më të lartë, vërtetohet nëse kihet parasysh vendimi i lëshuar në emrin S... A..., me numër 07/1-01A/3088 të datës 30.04.2015, nga ku shihet se të njëjtit me kalimin nga pozita teknik në specialist paga bazë i kishte ndryshuar nga 348.56 euro në 407.55 euro, e kjo vërtetohet edhe nga vet deklarata e paditësit i cili pohon se specialistet paguhën me koeficientin 7 ndërsa ai me koeficientin 6, e që bëhet e qartë se pozita Specialist ka të bëjë

me një pozitë të një grade më të lartë në raport me pozitën teknik, prandaj nga e gjithë kjo del se kjo kërkesë dhe ankesë është e pabazuar dhe madje është në kundërshtim edhe dispozitat dhe parimet e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Konkretisht është në kundërshtim me dispozitat e nenit 26 par.1, 2 dhe 4 të Ligjit të lartceku. Po ashtu është në kundërshtim edhe me Rregulloren 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbyesve Civil, ku në nenin 4 paragrafi 5 është përcaktuar “*avancimi në pozita drejtuese dhe ngritja në gradë brenda kategorisë së njëjtë funksionale bëhet në pajtim me rregulloren e nëpunësve civil. Ndërsa me Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, konkretisht nenin 9 par.1, janë përcaktuar kriteret për avancim në karrierë, ku në mënyrë taksative janë përmendur kushtet, si më poshtë: “1. Kriteret për avancim në karrierë të nëpunësit civil janë: 1.1. kalimi i kohës minimale në gradën e tyre ekzistuese në bazë të rregullave të përcaktuara më këtë Rregullore; 1.2. plotësimi i kërkesave profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën përkatëse; 1.3. kalimi me sukses të testimit me shkrim dhe me gojë; 1.4. rezultatet e vlerësimit në punë të jenë: mirë, shumë mirë ose shkëlqyeshëm; 1.5. të mos jetë në procedurë disiplinore; 1.6. të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në 3 vitet e fundit; si dhe rregulloren 1.7. të mos jetë iniciuar ndonjë procedurë penale”*. Prandaj në këtë kuptimi gjykata së shkallës së parë vlerësoi si të drejtë vendimin e kësaj të paditura nr.44-KA/A/2018, me të cilën ishte refuzuar ankesa e paditësit si e pabazuar, ngase e paditura MPB ndryshimin e vendit të punës apo ngritjen në pozitë të paditësit mund ta bëjë vetëm në pajtim me dispozitat ligjore si më lartë si të përcaktuar me Ligjin Për Shërbimin Civil dhe Rregulloret për Shërbimin Civil. Mbi këto arsye, gjykata së shkallës së parë vendimin e të paditurës me nr 44-KA-A/2018 të datës 14.06.2018 e vërtetoi si të drejtë dhe të bazuar si edhe në paragrafin 2 të këtij aktgjykimi. Dhe në këtë kuptim i konsideroi si të pabazuar dhe të paargumentuar pretendimet e paditësit për anulimin e këtij vendim, e që sipas tij kjo e paditur me vendimin e saj i kishte shkeluar të drejtat e tij sepse emrimin e tij në pozitën specialist me pa të drejtë e konsideron si avancimi, ndërsa në rastin e kolegut të tij S... A... nuk e kishte konsideruar avancim. Këtë refuzim të këtij pretendimi gjykata e bëri për arsyet si më lartë dhe duke u nisur nga fakti se në ankesën dhe vendimin në fjalë objekt i lëndës është kërkesa e tij për emërim në pozitën specialist, dhe në këtë mënyrë gjykata nuk lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit me të cilin S... A... nga pozita teknik kishte kaluar në pozitën Specialist, pasi që i njëjti nuk është objekt i padisë.

Prandaj duke qenë se vendim i të paditurës MPB, me nr 44-KA-A/2018 i datës 14.06.2018, është vlerësuar si i ligjshëm gjykata e shkallës së parë vendosi si në paragrafin 3 të këtij aktgjykimi, pasi që vërtetoi se pretendimet e paditësit që ti njihet koficienti 7 i pagesës dhe atë në mënyrë retroaktive ishin gjithashtu të pabazuar. Kjo ngase përmes vendimit 07/1-01A/1704 të datës 20.04.2018 dhe deklarimeve të paditësit dëshmohej se paditësi mban pozitën Teknik i tavolinës ndihmëse dhe paguhet me koeficient 6, ndryshe nga kolegët e tij në këtë rast nga S... A... i cili mban pozitën specialist dhe paguhet me koficient 7. Që do të thotë se nuk bëhet fjalë për pozita të njëjta, ndërsa në vërtetim të asaj se këto pozita kanë përshkrim të njëjtë të detyrave të punës paditësi nuk kishte sjell asnjë provë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimet e të autorizuarit të paditurit KPMSHC të dhëna në përgjigje në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesore, mirëpo të njëjtat pretendime si të tilla i vlerësoj si të pabazuara dhe nuk i aprovoi. E po ashtu vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës Avokatura e Shtetërore dhe të njëjta i vlerësoi si të pabazuar. Kjo nga fakti se, pretendimet e saj lidhur me mungesën e ligjitimit pasiv real nuk janë të qëndrueshme, ngase MPB është cilësuar si e paditur nga paditësi në seancën përgaditore të datës 10.05.2022 dhe i njëjti me qëllim të vendosjes meritore të çështjes i kishte kërkuar gjykatës edhe anulimin e vendimit të saj, konkretisht komisionit të ankesave. Po ashtu gjykata nuk morri për bazë pretendimet e tjera të saj parashtuar përmes kësaj përgjigje, ngase të njëjta kishin të bënin me vendimin nr.ref.07/1-01A/1704 të datës 27.04.2012, vendim ky që nuk është objekt i kontestit.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padë, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se padia e paditësit është pjesërisht e bazuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses të autorizuar të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative dhe kontestimore, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës KPMSHC në përgjigje në padë dhe të paditurës MPB, pastaj ka caktuar seancat dhe seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike, si në dispozitivin e tij dhe arsyetimin e aktgjykimit, gabimisht ka interpretuar ligjshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit F... Z..., duke aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë me të cilën ka anuluar vendimin A.nr.486/2018, të dt.21.09.2018 të KPMSHC, i cili ishte lëshuar në shqyrtime me të gjera pa qenë objekt i padisë respektivisht pa kërkesë të palës paditëse, duke ju referuar çështjes së avancimit dhe vetë e thekson se nuk është objekt i padisë, duke ju referuar rasteve të kolegeve të paditësit respektivisht ankuesit. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, për faktin se vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, sepse gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë pjesërisht të bazuara. Andaj, në këtë drejtim kolegji i kësaj gjykate konsideron se pretendimet ankimore të përfaqësueses të autorizuar, të paditurës, janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontest në arsyetimin e aktgjykimit, janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Andaj, pranë një gjendje të tillë faktike, kolegji i kësaj gjykate konsideron se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitatat ligjore në fuqi.

Kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore, se aktgjykimi i ankimuar është i përfshire me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, për arsye se në veten e tij është kontradiktor dhe kundërtëhënës. Pastaj se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, se për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, si dhe për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gabimisht ka zbatuar edhe të drejtë materiale. Këto pretendime ankimore, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase të njëjtat vlerëson se janë të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke pasur parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të pjeshëm të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

AA.nr.19/2023, me datë 28.12.2023

**Kryetari i kolegjit,**  
Ramiz Kuqi